

Ballina > Lajme > Arrestohen pesë "gangsterët" që bartnin armë pa leje

LAJME

Arrestohen pesë “gangsterët” që bartnin armë pa leje

28/05/2021



Policia ka njoftuar se vetëm të enjten ka arrestuar pesë persona për veprën penale, armë mbajtje pa leje.

Të dyshuarit janë arrestuar në Podujevë, Prishtinë, Prizren, Vushtrri dhe Rahovec.

Në rrugën Zahir Pajaziti në Podujevë, në orën 19:06, është arrestuar një person pasi iu konfiskua arma me dy predha dhe një karikator.

“Është arrestuar i dyshuari mashkull kosovar pasi që tek i njëjti gjatë kontrollit iu është gjetur dhe konfiskuar një armë me dy predha dhe një karikator. Me urdhër të prokurorit është bërë kontrolli i shtëpisë së dyshuarit, gjatë kontrollit është gjetur dhe konfiskuar edhe një armë dhe një karikator i zbrazët. Pas intervistimit në konsultim me prokurorin i dyshuari lirohet rasti shkon në procedurë të rregullt”, bëhet e ditur në raport.

Ndërsa në Prishtinë, rreth orës 22:00, është arrestuar pasi gjatë kontrollonit të veturës i është gjetur armë dhe 5 fishekë të vendosur në karikator.

“Raportohet se gjatë kontrollit në veturën e të dyshuarit është gjetur një armë dhe 5 fishekë të vendosur në karikator, një qese me substancë narkotike që dyshohet të jetë llojit kokainë. Pas intervistimit në konsultim me prokurorin i dyshuari lirohet ,rasti shkon në procedurë të rregullt .Rasti duke u hetuar”, thuhet në raport.

Në Vermicë të Prizrenit, është arrestuar një person dhe i është konfiskuar një pistoletë, një karikator dhe 16 fishekë.

“Raportohet se gjatë kontrollit në veturën e të dyshuarit mashkull kosovar është gjetur dhe konfiskuar një pistoletë , një karikator ,16 fishekë .Pas intervistimit në konsultim me prokurorin i dyshuari është liruar, rasti shkon në procedurë të rregullt”.

Rast po i njëjtë ka ndodhur edhe në Vushtrri, ku është konfiskuar revole me 9 copë fishekë.

“Gjatë kontrollit te i dyshuari mashkull kosovar është gjetur në posedim dhe konfiskuar një revole me një karikator me 9 copë fishekë. Me urdhër të prokurorit rasti vazhdon në procedurë të rregullt”.

E në fshatin Ratkoc të Rahovecit, një personi i është konfiskuar një pushkë.

“Është arrestuar i dyshuari mashkull kosovar pasi gjatë kontrollit në shtëpinë e tij është gjetur dhe konfiskuar një pushkë gjysëmautomatike e kal.7.62 mm dhe 28 copë fishek. Me urdhër të prokurorit i dyshuari është liruar, rasti vazhdon në procedurë të rregullt”, thuhet në raportin e policisë.

f Fansa PËLQEJE

Instagram Ndjekësit NDJEK

SOCIALE

Familja nga Hajvalia në gjendje të rëndë, nuk po mund të ngopen as me...

25/12/2020

Policja diagnostikohet me leukemi, familja kërkon ndihmën e qytetarëve

09/12/2020

Ndërron jetë profesori i njohur

13/01/2021

20-vjeçarja nga Prishtina vuan nga tuberkulozi, kërkohet ndihmë për shërimin e saj

10/02/2021

< >

ARTIKUJ TË NGJASHËM

MË SHUMË NGA AUTORI

< >

Lajme

Avokati i Gucatit: Pozicioni i ZPS-së po bëhet gjithmonë e më i pavërtetë, këtu po thonë gënjeshtër

Lajme

Rrëfimi i ushtarit të KFOR-it me mision në Kosovë, më mungojnë 5 fëmijët dhe grua

Lajme

Kapet me marihuanë një grua në Burgun e Dubravës